LIGJ
Nr. 62/2022

PËR REGJISTRIN KOMBËTAR TË TË DËNUARVE PËR KRIME SEKSUALE

Në mbështetje të neneve 54, 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me nismën e më shumë se 20 mijë zgjedhësve, si dhe të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka si objekt:

1. Përcaktimin e parimeve, rregullave dhe procedurave në bazë të të cilave ndërmerret krijimi dhe funksionimi i Regjistrit Kombëtar i të Dënuarve për Krime Seksuale.

2. Përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit në nivel qendror dhe vendor dhe detyrat e tyre përkatëse.

3. Sigurimin e monitorimit të procesit të regjistrimit të të dënuarve për krime seksuale.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin e ngacmimit, dhunës, abuzimit apo shfrytëzimit seksual të çdo individi që jeton në Republikën e Shqipërisë.

2. Përcaktimin e rregullave për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale.

3. Caktimin e përgjegjësive për autoritetet përgjegjëse, autoritetet e tjera dhe çdo institucion apo organizata publike ose private, që punojnë për fëmijët ose viktimat e dhunës seksuale.

4. Marrjen e masave për evidentimin e plotë në Regjistër të të gjithë të dënuarve për krime seksuale.

5. Rregullimin e lëvizjes dhe veprimeve të të dënuarve, duke kufizuar kontaktin fizik ose virtual të tyre me viktimat e mundshme të krimeve seksuale.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Autor i krimeve seksuale" është çdo person i dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të parashikuara në pjesën e posaçme, kreu II, seksioni VI "Krimet Seksuale" të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

b) "Baza e të dhënave" është sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

c) "Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve" është organi kompetent, i cili krijon, përditëson dhe mirëmban bazën e të dhënave që vërtetojnë gjendjen gjyqësore.

ç) "Drejtoria e Përgjithshme e Policisë" është organi kompetent që për qëllime të këtij ligji do të shfrytëzojë dhe do të përditësojë me të dhëna të tjera sipas këtij ligji Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, si pjesë përbërëse e bazës së të dhënave që vërtetojnë gjendjen gjyqësore.

d) "Drejtoria Vendore e Policisë" është organi kompetent që do të mbledhë të dhënat për regjistrimin e autorëve të krimeve seksuale.

dh) "Kontrollues" në kuptim të këtij ligji është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, referuar ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe regjistrit elektronik të subjekteve kontrolluese të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

e) "Komisariati i policisë" është organi kompetent që do të mbledhë të dhënat e përditësuara të autorëve të krimeve seksuale.

ë) "Krime seksuale" janë të gjitha veprat penale sipas parashikimeve të bëra në pjesën e posaçme, kreu II, seksioni VI "Krimet Seksuale" të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

f) "Përpunues" në kuptim të këtij ligji është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, referuar ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

g) "Regjistër themeltar elektronik i gjendjes gjyqësore" ka të njëjtin kuptim të dhënë në ligjin nr. 9614, datë 21.9.2006, "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore".

gj) "Regjistri Kombëtar i të Dënuarve për Krime Seksuale" është një regjistër në të cilin regjistrohen të dhëna të përditësuara, sipas parashikimeve të këtij ligji, për autorët e krimeve seksuale.

h) "*Single Sign-On*" është skema unike e identifikimit të përdoruesve, duke përdorur një ID dhe fjalëkalim të vetëm në platforma dhe sisteme të ndryshme të *e-Qeverisje*-s, për garantimin e besueshmërisë dhe të sigurisë në ofrimin e shërbimeve elektronike.

i) "Të dhëna parësore" janë informacione specifike të mbledhura nga institucioni administrues në përputhje me aktin e krijimit.

j) "Të dhëna dytësore" janë të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore.

KREU II
PARIMET THEMELORE

Neni 4
Parime të përgjithshme

Ky ligj respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në aktet e tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës.

Neni 5
Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës

Të gjitha autoritetet përgjegjëse, institucionet publike dhe private ose personat që për shkak të marrëdhënieve të punës kanë akses në Regjistër, në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij ligji duhet të vlerësojnë dhe zbatojnë me përparësi mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 6

Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit

1. Të dhënat personale të personave të regjistruar në Regjistër duhet të përpunohen në përputhje me parimet dhe kriteret e sanksionuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Palët që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Neni 7

Parimi i vërtetësisë dhe objektivitetit

1. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin që gjatë veprimtarisë së tyre të mbledhin dhe regjistrojnë me vërtetësi dhe korrektësi informacionet dhe të dhënat që shënohen në Regjistër, si dhe t'i transmetojnë të dhënat në mënyrë të qartë te subjektet që sipas këtij ligji kanë akses në Regjistër.

2. Në rast të regjistrimit ose transmetimit të informacioneve të pasakta, autoritetet përgjegjëse marrin masa për korrigjimin e tyre.

KREU III

REGJISTRI KOMBËTAR I TË DËNUARVE PËR KRIME SEKSUALE

Neni 8

Krijimi dhe administrimi i Regjistrit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është organi kompetent, i cili krijon, administron, përditëson dhe mirëmban bazën e të dhënave që vërtetojnë gjendjen gjyqësore të personit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është organi kompetent që për qëllime të këtij ligji do të shfrytëzojë e përditësojë me të dhëna të tjera sipas këtij ligji Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, si pjesë përbërëse të bazës së të dhënave që vërtetojnë gjendjen gjyqësore.

3. Të dhënat që duhet të përmbajë ky Regjistër i posaçëm përcaktohen në këtë ligj.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit koordinon punën me drejtoritë vendore të policisë, duke iu përcjellë të dhënat për autorët, vendbanimet ose vendqëndrimet e të cilëve janë nën juridiksionin e tyre.

5. Pranë çdo drejtorie vendore të policisë në qarqe caktohet një punonjës policie, i cili ka për detyrë funksionale evidentimin, intervistimin dhe përditësimin e të dhënave të të dënuarve për krime seksuale.

Neni 9

Përmbajtja e Regjistrit Kombëtar

Regjistri përbëhet nga të dhëna parësore, dytësore dhe të tjera.

Të dhëna parësore janë:

a) numri identifikues i dosjes unike të personalizuar;

b) raporti periodik i verifikimit/monitorimit nga Drejtoria dhe komisariati vendor i policisë.

Të dhëna dytësore janë:

a) të dhëna personale dhe adresa nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe Regjistri Kombëtar i Adresave;

b) të dhëna nga sistemi *e-Taxation* në lidhje me punësimin;

c) të dhëna nga Regjistri për Gjendjen Gjyqësore;

d) të dhëna nga Regjistri për Shërbimin e Provës.

Të dhëna të tjera janë;
a) numri i telefonit fiks ose/dhe celular;
b) adresa e postës elektronike.

Neni 10
Ndërtimi dhe menaxhimi i faqes *web*

Regjistri i të Dënuarve për Krime Seksuale do të ketë ndërfaqe pas identifikimit të të interesuarit nëpërmjet teknologjisë *single sign- on* të *e-Albania*.

Kontrolluesit dhe përpunuesit që do të kenë akses në Regjistër duhet të marrin masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të përshtatshëm sigurie në raport me përpunimin e të dhënave sensitive.

Neni 11
Detyrimet për raportimin e të dhënave

1. Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të dhënat për çdo person që ka përfunduar vuajtjen e dënimit si autor i krimit seksual.

2. Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të dhënat e vuajtjes së dënimeve alternative për çdo autor të krimit seksual.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë koordinon punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Shërbimit të Provës, me qëllim raportimin në kohë reale të këtyre të dhënave.

4. Drejtoria Vendore e Policisë ose komisariati i policisë ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin autori i krimeve seksuale, ka për detyrë të sigurohet që të dhënat e autorit të krimeve seksuale të përfshijnë:
a) të dhënat e vendimit gjyqësor, si: numër vendimi, datë, gjykata që ka dhënë vendimin;
b) lloji i veprës penale dhe masa e dënimit të dhënë;
c) të dhëna që lidhen me gjendjen shoqërore dhe familjare të të dënuarit;
ç) të dhëna që lidhen me veprën penale;
d) vërtetim i gjendjes gjyqësore;
dh) fotografi aktuale e autorit të krimeve seksuale;
e) kartelë daktiloskopike (kopje);
ë) leje drejtimi automjeti.

Neni 12
Detyrime të tjera për Regjistrin

1. Nëse bëhen ndryshime në të dhënat e Regjistrit, duhet të pasqyrohet arsyeja e shënimeve ose ndryshimeve, si dhe data, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit që i ka bërë këto shënime.

2. Çdo institucion cakton një person përgjegjës që administron Regjistrin, kontaktet e të cilit përcillen pranë Drejtorisë Vendore të Policisë.

Neni 13
Aksesi në Regjistër

1. Të dhënat e përditësuara të autorit të krimeve seksuale, komisariati i policisë ia përcjell Drejtorisë Vendore të Policisë dhe kjo e fundit Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

2. Drejtoria Vendore e Policisë duhet të njoftojë për përditësimin e të dhënave të autorëve të krimeve seksuale:

a) Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkinë ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin i dënuari për krime seksuale;

b) organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e fëmijëve dhe personave vulnerabël;

c) Departamentin e Administratës Publike për verifikimin e figurës së nëpunësit duke ekspozuar të dhëna në rrugë elektronike për databazat përkatëse;

ç) sistemin shkollor parauniversitar për verifikimin e figurës së mësuesit/edukatorit duke ekspozuar të dhëna në rrugë elektronike për databazat përkatëse.

3. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave.

4. Të gjithë aksesuesit, persona fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, si dhe çdo subjekt i interesuar aksesojnë të njëjtin nivel të dhënash, i cili referon vetëm në faktin nëse personi ka qenë ose jo i dënuar për ndonjë nga krimet seksuale në kuptim të këtij ligji.

5. Çdo institucion publik ose privat, përpara se të emërojë, rekrutojë personel ose të fillojë çdo marrëdhënie punësimi, ka detyrimin të kërkojë verifikim tek autoriteti përgjegjës nëse kandidati që ka shprehur interesin për pozicionin e shpallur vakant figuron ose jo i regjistruar në Regjistër për punësimin si:

a) mësues dhe punonjës në sistemin arsimor në çdo nivel të sistemit parauniversitar;

b) punonjës, infermierë, mjekë në sistemin shëndetësor në çdo nivel të ofrimit të shërbimit;

c) kujdestar ligjor, jo prind, i një personi sipas vendimit të gjykatës;

ç) punonjës i institucioneve të përkujdesjes shoqërore dhe ofrimit të shërbimeve të përkujdesjes sociale në qendra rezidenciale, qendra komunitare, familje kujdestare etj.;

d) punonjës, edukatorë apo predikues në institucionet fetare, që kanë akses te fëmijët apo shërbimet ndaj tyre;

dh) punonjës bashkiakë në qendra ose institucione kulturore, qendra trajnimi apo sportive;

e) edukatorë në sistemin parashkollor;

ë) trajnerë ose staf ndihmës në çdo lloj sporti që ndiqet nga fëmijët;

f) punonjës për organizatat joqeveritare që punojnë në mbrojtje apo kujdesen për fëmijët, si dhe

g) në çdo marrëdhënie punësimi, veprimtaria e të cilës ka lidhje me fëmijët, me persona vulnerabël, me persona me aftësi të kufizuara etj.

6. Detyrimi për verifikimin e figurës së personit ekziston edhe për stafin e punësuar në të gjitha veprimtaritë e përmendura më sipër. Nëse nga verifikimi rezulton se personi është i regjistruar si i dënuar për krime seksuale në Regjistër, institucioni/organizata merr masa për ta transferuar personin në një pozicion ku nuk ka akses te fëmijët apo personat vulnerabël.

Neni 14

Raportimi

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raportojnë një herë në vit përpara Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë.

2. Një kopje e këtij raporti i dërgohet Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

.

Neni 15

Institucione të tjera përgjegjëse

1. Ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike cakton njësinë përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që monitoron dhe përditëson të dhënat e Regjistrit, si pjesë përbërëse e të dhënave që vërtetojnë gjendjen gjyqësore.

2. Ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë cakton njësinë përgjegjëse për informimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me përfundimin e vuajtjes së dënimit të personave të dënuar për krime seksuale.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale harton programe të posaçme për trajtimin, integrimin dhe rehabilitimin shëndetësor, social, moral dhe ekonomik të viktimave të krimeve seksuale dhe të personave të dënuar për kryerjen e tyre.

Neni 16

Forma dhe kohëzgjatja e ruajtjes së Regjistrit

Të dhënat dhe informacionet e regjistruara në Regjistër, sipas kërkesave të nenit 9 të këtij ligji, ruhen deri në ditën e vdekjes ose deklarimit si i vdekur të të dënuarit për krime seksuale.

Neni 17

Detyrimi për shtetasit e huaj ose pa shtetësi

Shtetasi i huaj ose pa shtetësi, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, i cili është dënuar për krime seksuale, ka detyrimin që në përfundim të vuajtjes së dënimit të deklarojë të dhënat e tij në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale sipas parashikimeve të këtij ligji.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 18

Afati për ngritjen e Regjistrit

Ministri i Drejtësisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 6 muajve nga botimi i këtij ligji në Fletoren Zyrtare, ngarkohen për marrjen e të gjitha masave për vënien në funksion të Regjistrit Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale.

Neni 19

Dispozita kalimtare

Ky ligj i shtrin efektet juridike edhe për të dënuarit për krime seksuale të rehabilituar.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.7.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13842, datë 5.8.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.